


Nga vizioni në inovacion: Rrugëtime frymëzuese të grave në teknologji



EUROPE
HOUSE





Hyrje

Pjesëmarrja e grave dhe vajzave në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM) nuk ka të bëjë vetëm me përfaqësimin, por edhe me përparimin. Çdo shoqëri që dëshiron të sjell inovacion, të zhvillohet e të lulëzojë, duhet të sigurojë që gratë të kenë qasje të barabartë në arsim, mundësi dhe lidrshp. Në mbarë Evropën, ashtu si edhe këtu në Kosovë, Bashkimi Evropian punon që ta mbyllë hendekun gjinor në STEM, duke mbështetur programe të edukimit, bursa, nisma të mentorimit dhe rrjete profesionale që i fuqizojnë gratë e reja që të eksplorojnë, të mësojnë e të udhëheqin. Kur gratë dhe vajzat kanë qasje në dije dhe teknologji, ato jo vetëm që i japin trajtë të ardhmes së vet, por edhe ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie që është më e qëndrueshme, më kreative dhe që sheh kah e ardhmja.

Kemi parë sa e sa herë se kur ka pjesëmarrje të plotë të grave në ekosistemet digjitale dhe të inovacionit, ato sjellin këndvështrime të reja, bashkëndjesi dhe shkathtësi të zgjidhjes së problemeve nga të cilat përfitojnë të gjithë. Kontributet e tyre i japin shtysë transformimit teknologjik, nga klasat e deri te laboratorët e



kodimit, nga bizneset fillestare e deri te institucionet publike. Ky publikim, "Nga vizioni në inovacion: Rugëtime frymëzuese të grave në teknologji", u thur lavde grave që e kanë pasur guximin që ta bëjnë hapin e parë në hapësira në të cilat kanë qenë shpesh të vetme në mesin e burrave, që sfidat i kanë kthyer në të arritura dhe që tash janë frymëzim për gratë e vajzat e tjera që duan ta ndjekin shembullin e tyre. Rugëtimet e tyre na e kujtojnë se barazia në STEM, përveçse vlerë që e mbështesim, është investim në një lloj të ardhmeje që duam ta krijojmë: përfshirëse, inovative dhe të nxitur nga potenciali i të gjithëve. Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar ndaj këtij vizioni. Nëpërmjet mbështetjes së kamotshme të saj për edukim, hulumtimin dhe inovacionin digjital në Kosovë, BE-ja do të vazhdojë të ndihmojë në krijimin e mundësive që gratë dhe vajzat të udhëheqin, të sjellin inovacion dhe ta formësojnë një të nesërme më të mirë.

Eva Palatova

Zëvendësshefe e Bashkimit Evropian në Kosovë

Përmbajta

Hyrje	3
I – Nismëtarët që hapin rrugë	6
Teuta Sahatqija	7
Dr. Edona Maloku	8
Prof. Dr. Jellena Gjokiq	9
Vjollca Çavolli	11
II – Nderojmë rrugëtimet e grave në TI	11
Adelina Neziri	13
Shqipe Neziri Vela	15
Blerta Thaçi	17
Valdete Marevci- Dërmaku	21
III – Intervista me gratë që po e bëjnë ndryshimin në sektorin e TIK-ut	21
Abetare Gojani	22
Jeta Zagragja	24
Donjeta Sahatçiu	26
Zana Tabaku	28
IV – Katalizatorët e ndryshimit	30
STIKK	31
Gratë në STEM në Kosovë	31
Global Engineer Girls (GEG Kosova)	32
Vajzat në TIK	32
V – Forcat bashkëpunuese në qendër të vëmendjes	34
KosICT	35
DOKU.TECH	36
Java Globale e Ndërmarrësisë	37
VI – Edukatorët që e trasojnë rrugën për vajzat në teknologji	38
Akademia jCoders	39
Foundation House	40
Shkolla Digjitale	41
VII – Urat midis arsimit dhe mundësive	44
VentureUP	45
Cactus Education	46
BIT Academy	47
Qendra e Inovacionit Graçanica	48
VIII – Transformimi: Nga nxënëse në sipërmarrëse	50
Poshtëshkrim	54





I – Nismëtarët që hapin rrugë

Fuqizim. Frymëzim. Inovacion. Veprim. Këto fjalë e ngërthejnë shpirtin e grave që po ia ndryshojnë imazhin e teknologjisë në Kosovë dhe më gjerë. Me mbështetjen e Bashkimit Evropian, platforma të ndryshme po krijojnë mundësi të reja për vajzat dhe gratë që duan të guxojnë, të mësojnë dhe ta ndërtojnë të ardhmen e vet dhe të ardhmen e të tjerave në fushat e STEM-it. Në këtë publikim janë prezantuar rrëfimet, zërat, veprimet dhe vizionet e grave që nuk presin që të ftohen në tryezë, por e ndërtojnë vetë atë.



Teuta Sahatqija

*Drejtoresh Ekzekutive,
Women in Tech Kosovo*

Frymëzim në terren

Kur e kam nisur karrierën time si programuese, nuk ka pasur gra në programim dhe, në fakt, edhe burrat kanë qenë pakicë në këtë profesion. Por sot, në Fakultetin Teknik, në fakultetin ku unë kam studiuar, vajzat përbëjnë gjysmën e studentëve. Për mua, ky nuk është vetëm numër, por tregues se ndryshimi është i mundur. Përmes angazhimeve të mia si Drejtoresh Ekzekutive në Women in Tech Kosovo (rrjet jofitimprurës që i fuqizon vajzat dhe gratë në STEM, duke i lidhur ato me mentorë, duke ofruar trajnime për shkathtësi dhe duke avokuar për mundësi të barabarta në ekosistemin teknologjik në mbarë Kosovën), kam punuar përkrah vajzave që duan të provojnë, të dështojnë e të ringrihen. Me projekte si "Dita e Vajzave në TIK" dhe bashkëpunime me projekte të ndryshme, kam parë se kur vajzat ndihen të përkrahura, ato nuk njohin kufij dhe shkëlqejnë. Kur shoh një vajzë ose një grua duke



udhëhequr, duke programuar apo duke ligjëruar, e di se ajo e kupton: "Edhe unë mund ta bëj". Ky është ndryshimi i vërtetë.

Mesazhi im për vajzat e reja është: Mos prisni që dikush tjetër t'ua hapë derën. Ndërtojeni vetë atë! Secili kod që e shkruani, secila ide që e zhvilloni, secili hap përpara është hap drejt botës që doni ta shihni. Besoj fuqishëm se bota e teknologjisë ka nevojë për ju, për zërin tuaj, për inteligjencën tuaj dhe për bashkëndjesinë që vetëm ju mund ta sillni.



Dr. Edona Maloku

Ish-Zëvendësministre e Arsimit (maj 2021 – korrik 2023)

Politikat që krijojnë mundësi

Rrugëtimi im në mbështetjen e grave dhe vajzave në STEM filloi si hulumtuese e më vonë si hartuese e politikave. Si akademike, i kam studiuar barrierat sociale dhe psikologjike që e pengojnë pjesëmarrjen e grave në STEM, duke i dokumentuar stereotipet, pritjet familjare dhe praktikat shkollore që shpesh e nënvlerësojnë potencialin e vajzave, përkundër rezultateve akademike të larta të tyre. Për këtë arsye, kam punuar në hartimin e politikave dhe nismave që u ndihmojnë vajzave që të qëndrojnë dhe avancojnë në STEM, duke përfshirë mentorimin, bursat dhe programet për modelim të roleve. Një kontribut i veçantë që e kam dhënë gjatë kohës sa kam qenë Zëvendësministre e Arsimit (maj 2021 – korrik 2023) ka qenë krijimi i rrjetit “STEMinistet”, platformë kombëtare kjo për rrjetëzim, mentorim dhe shkëmbim të përvojave për gratë në STEM në



Kosovë. Kjo platformë dëshmon se kur bashkohen hulumtimi, politikat dhe avokimi, mund të krijohen hapësira që i tejkalojnë barrierat dhe stereotipet gjinore.

Mbështetja e familjes dhe shoqërisë janë po aq esenciale, sepse besimi dhe inkurajimi që u jepet vajzave në mjedisin e ngushtë të tyre shpesh e përcakton vendimin për ta ndjekur ndonjë karrierë në STEM. Integrimi i politikave të qëndrueshme dhe mbështetja e vazhduar për edukimin e vajzave janë esenciale për ta transformuar talentin e tyre në mundësi reale për zhvillim, inovacion dhe ndikim shoqëror. Besoj fuqishëm se çdo vajzë në Kosovë e meriton mundësinë për ta parë veten si shkencëtare, inxhinieri apo inovatore.



Prof. Dr. Jellena Gjokiq

*Profesoreshë e inxhinierisë
së mjedisit
Universiteti Publik në
Mitrovicë të Veriut*

Profesoresha e inxhinierisë që u frymëzua nga Trepça

Jam lindur në një qytet të minierave dhe metalurgjisë, ndërsa të dy gjyshërit e mi kanë punuar në kombinatin e Trepçës. Kur erdhi koha të vendosja se çka do të studioja, ishte e natyrshme për mua që ta vazhdoja trashëgiminë familjare dhe t'i kontribuoja komunitetit përmes inxhinierisë dhe teknologjisë.

Në fillim, anëtarët e familjes sime kishin mëdyshje. Mendonin se inxhinieria ishte shumë e vështirë për një vajzë dhe më këshilluan ta studioja ekonominë ose gjuhët. Por kjo vetëm sa më bëri më të vendosur. Doja të dëshmoja se isha po aq e aftë sa secili djalë student. Kështu, zgjodha ta studioja inxhinierinë e mjedisit në Fakultetin e Shkencave Teknike (Universiteti Publik në Mitrovicë), ku tani jap



mësim si profesoreshë e rregullt. Kur e nisa karrierën sime, më duhej t'ua dëshmoja përkushtimin dhe kompetencën time kolegëve të mi meshkuj. Me kalimin e kohës, e ndërtova reputacionin tim në bazë të meritave, e jo të përkatësisë gjinore. Në klasë, u bëra mentore dhe udhëzuese për vajzat e reja që kërkonin dikë që besonte në potencialin e tyre. Sot, e shoh një transformim të qartë. Shumë vajza po studiojnë teknologji dhe inxhinieri dhe, në shumicën e rasteve, ato po tregojnë përkushtim dhe rezultate të jashtëzakonshme. Tash jam mentore si e kandidateve gra, ashtu edhe e kandidatëve meshkuj për doktoraturë në mënyrë të barabartë, ndërsa shoh se sa shumë besim dhe pasion sjellin gratë e reja në shkencë kur ndihen të mbështetura.

Mesazhi im për vajzat e reja është i thjeshtë: Jini këmbëngulëse, të durueshme dhe të guximshme! Kërkoni dije, besoni në vetveten dhe kurrë mos lejoni që rrugën t'ua përcaktojnë stereotipet! Me mbështetjen familjare dhe institucionale, gratë në shkencë mund të arrijnë ekuilibër, inovacion dhe lidërsip. Arsimi nuk është vetëm karrierë; është themeli i barazisë.



Vjollca Çavolli

Drejtoresh Ekzekutive, STIKK

Përpjekja dhe vizioni për gratë në TI

Nisa të merrem me teknologjinë në një kohë kur prania e grave ishte minimale, ndërsa sfidat e para ishin paragjykimet sociale se teknologjia është profesion për burrat dhe mungesa e mundësive të strukturuar për zhvillim profesional. Megjithatë, përkushtimi personal dhe dëshira për të qenë pjesë e një sektori që e transformon shoqërinë më motivuan që të ec përpara.

Sot, pjesëmarrja e grave në TI në Kosovë po rritet çdo vit, falë përkushtimit të organizatave, si dhe projekteve e nismave për fuqizim të grave në këtë sektor. Ndiqja që e ka ofruar Bashkimi Evropian për ta forcuar këtë sektor ka qenë e jashtëzakonshme. Ka biznese të reja të grave që punën e kanë filluar pikërisht falë kësaj ndihme. Stereotipet, mungesa e modeleve frymëzuese dhe rrjetet profesionale



të kufizuara mbeten pengesa reale për vajzat që hyjnë në teknologji. Për t'i kapërcyer këto pengesa, përveç mentorimit, bursave dhe mundësive të dedikuara për praktikë, ka nevojë për vetëdijesim në mesin e prindërve dhe mësimdhënësve, si dhe për politika për punësim që e mbështesin barazinë gjinore dhe zhvillimin profesional të grave. Të gjitha vajzave që ëndërrojnë të bëhen pjesë e TI-së, dua t'u them: Teknologjia është fushë e hapur për këdo që ka pasion, kreativitet dhe këmbëngulje. Besoni në aftësitë tuaja, kërkoni mbështetje nga rrjetet e duhura dhe ndiqni ëndrrat tuaja me vendosmëri. Çdo hap përpara është shembull që tregon se gratë dhe vajzat i përkasin shkencës, teknologjisë dhe inovacionit dhe mund të kenë ndikim të fuqishëm në të ardhmen e Kosovës.



II – Nderojmë rrugëtimet e grave në TI

Në çdo kod, në çdo rrjet dhe në çdo ide që e ndryshon mënyrën se si ne jetojmë ka një histori njerëzore; në shumë nga to, një vajzë që ka guxuar të mos dorëzohet. Ky kapitull i dytë rrjedh natyrshëm prej vizioneve të grave lidere, duke e sjellë më afër realitetin e përpjekjeve, sfidave dhe vendosmërisë që e përbëjnë rrugëtimin në teknologji. Blerta, Adelina, Shqipja dhe Valdetja, secila me historinë e vet, dëshmojnë se rruga drejt suksesit nuk është përherë e drejtë, por është e mundur.



Adelina Neziri

*Inxhinierë e dalluar në
Nettxio*

**Inxhinierja që e “mbuloi”
Kosovën me internet.**

Rrugëtimi i saj në telekomunikacion filloi me kureshtje dhe frymëzim nga familja e saj. “Si fëmijë, e admiroja punën e babait tim, inxhinier i dalluar në sektorin e energjisë, dhe kjo më motivoi t’i ndiqja studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Universiteti i Prishtinës), me fokus në telekomunikacion. Ky admirim, i shoqëruar me natyrën time gjithmonë në kërkim të zhvillimit dhe mësuarit të diçkaje të re, ma bëri të lehtë që ta zgjedhja këtë fushë”, thotë inxhinierja Adelina Neziri.

Puna në këtë sektor nuk ka qenë pa sfida. “Sfida më e madhe ka qenë që të isha përherë në hap me zhvillimet e shpejta në teknologji, posaçërisht në telekomunikacion, si dhe ta gjeja një ekuilibër midis punës sime profesionale dhe jetës familjare”,



thotë Adelina. Megjithatë, pasionit dhe përkushtimit të saj i është bashkuar kënaqësia nga të arriturat reale: “Kur puna e inxhinierëve realizohet dhe kur shihet rezultati përfundimtar i suksesshëm, kjo konsiderohet e arritur. Së pari, kjo të përmbushë emocionalisht dhe profesionalisht, e pastaj të motivon që të mos ndalesh me aq”.

Një nga të arriturat më të rëndësishme të Adelina Nezirit është kontributi i saj në planifikimin e teknologjive të reja të telekomunikacionit në IPKO, njëra nga kompanitë më të mëdha të telekomunikacionit që i mbulon zonat urbane dhe rurale të Kosovës. “Sot, rrjeti mbulon më shumë se 98% të territorit të vendit”, thekson ajo. Për të, suksesi nuk matet vetëm me një projekt të përfunduar, por edhe me qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë në të mësuar dhe inovacion:

“Ata inxhinierë që ia dalin të jenë në hap me ndryshimet teknologjike, do të ndihen të realizuar në punën e vet”.

Vajzave të reja që ëndërrojnë të ndjekin rrugën e saj, Adelina u thotë:

“Unë i inkurajoj vajzat e reja vazhdimisht që të besojnë në vetvete dhe t’i ndjekin ëndrrat e tyre, përkundër pengesave apo paragjykimeve që mund të shfaqen gjatë rrugës. Mundësitë për të punuar në fusha të ndryshme të teknologjisë janë të shumta, ndërsa kompanitë ofrojnë hapësirë për praktika dhe zhvillim”.

Adelina aktualisht punon në Netxio, ku kontribuon në shërbimet e telekomunikacionit për operatorë në ShBA, ndërsa thekson se çdo hap profesional që e ndërmarrin gratë e reja e ka potencialin për të hapur dyer të reja.



Shqipe Neziri Vela

*Bashkëthemeluese dhe
Kryesuese, Gratë në Energji
dhe Miniera*

Nga gazetaria në energji dhe ndikim global

Rrugëtimi i Shqipes ka filluar larg sektorit të energjisë – si gazetarë në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), duke i mbuluar temat e të rinjve në një shoqëri pas konfliktit. “Atje mësova se sa e rëndësishme është t’u japësh zë temave që ndikojnë në njerëzit, por edhe sa ndikim mund të kenë politikat publike në jetën tonë të përditshme”, thotë ajo duke i sjellë ndërmend fillesat e saja, të cilat e çuan drejt studimeve për politikat publike e pastaj në një kurs të veçantë për politikat e energjisë në Institutin e Teknologjisë Rochester (RIT), ku ajo zbuloi se: “Pas çdo vendimi për energjinë qëndron një histori e zhvillimit, strategjisë dhe ndikimit social. Energjia nuk e nënkupton vetëm prodhimin e energjisë elektrike,



por pikëtakimin e teknologjisë, politikave dhe jetës së përditshme”.

Prej atëherë, karriera e saj ka lëvizur nga hartimi i ligjeve dhe strategjive në menaxhimin e programeve globale për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) në Oslo. “Nuk ka qenë rrugë e lehtë, por sfidat më kanë bërë më të vendosur dhe më kanë motivuar që të mos pranoja të isha vetëm një “pjesëmarrëse simbolike”.

Vullneti i saj për t’i mbështetur gratë dhe vajzat në sektorin e energjisë e çoi drejt krijimit të Rrjetit për Gratë në Energji dhe Miniera në Kosovë. “Vendosëm të mos prisnim më dhe e krijuam një

rrjet për t'i lidhur dhe fuqizuar gratë dhe vajzat që punojnë në energji dhe miniera", thotë ajo.

Sot, ky rrjet i ka më shumë se 100 anëtare dhe është pjesë e mekanizmave globalë, duke krijuar modele frymëzuese dhe hapësira mentorimi për gjeneratat e reja.

Shqipja beson se gratë janë vendimtare për tranzicionin energjetik: "Kur gratë janë pjesë e procesit, diskutimet janë më të balancuara, ndërsa zgjidhjet janë më kreative. Tranzicioni i drejtë nuk mund të ndodhë pa përfshirjen e grave, jo si obligim, por si domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm".

Këshilla e saj për vajzat që duan ta ndjekin rrugën e energjisë, është:

"Mos e kufizoni veten për shkak të frikës ose stereotipeve! Përgatituni mirë, kërkonit mentore dhe mos kini frikë që të aplikoni për pozita që duken se janë jashtë zonës së rehatisë tuaj! Çdo hap, madje edhe një hap i vogël, i kontribuon një ndryshimi më të madh".



Blerta Thaçi

*Drejtoresh Ekzekutive,
Open Data Kosova*

Rrugëtimi i Blerta Thaçi në teknologji

“Rrugëtimi im në teknologji nuk ka nisur me ndonjë plan të qartë, por me një ndjenjë të thellë të kureshtjes”, thotë Blerta Thaçi. Gjatë shkollimit parauniversitar të saj, ajo e ndjeu se logjika dhe zgjidhja e problemeve ishin më tërheqëse për të sesa teoritë. “Më tërhiqte mënyra si funksiononin pajisjet, programet dhe strukturat. Kjo më çoi natyrshëm në inxhinieri kompjuterike në universitet, një fushë ku mund të eksploroja dhe ta sfidoja veten çdo ditë”, shpjegon ajo.

Dhe sfida kishte plot. “Porsa i mbarova studimet, tregu i punës ishte i vështirë: kriteret e larta, përvoja minimale dhe mundësitë e pakta për të mësuar në praktikë. Në vend që të sprapsesha, ndoqa trajnime pas orarit të punës, e testova vetë teknologjinë dhe



mësova me hapa të vegjël, por të qëndrueshëm. Kuptova se suksesi nuk matet vetëm me shkathtësi, por edhe me durim dhe konsistencë”, thotë Blerta.

Njohja me konceptin e të dhënave të hapura qe moment vendimtar. “Nuk ishte më vetëm teknologji për zgjidhje teknike, por teknologji për fuqizim civil”, thotë ajo. Kjo e bëri që t’i bashkohej Open Data Kosovo, një organizatë jofitimprurëse që zhvillon mjete digjitale dhe zgjidhje për të dhënat e hapura për t’i bërë institucionet më transparente dhe më llogaridhënëse. “Teknologjia nuk është neutrale! Mënyra si dizajnohet dhe përdoret ajo mund ta forcojë ose dobësojë demokracinë, barazinë dhe drejtësinë sociale”, thekson Blerta.

Përvoja e saj në Open Data Kosovo ia ka forcuar bindjen se teknologjia dhe bashkëpunimi mund ta nxisin ndryshimin. Duke u bazuar në atë përvojë, ajo më vonë e themeloi ZenVen Coworking Space, “një kombinim i qetësisë së shtëpisë, dhe produktivitetit të zyrës”, siç shpjegon ajo. ZenVen është vatër e shumë historive të suksesit të profesionisteve që ia kanë nisur vetë, por kanë krijuar ekipe, bashkëpunime që kanë nisur në ndonjë kafene dhe janë shndërruar në projekte të financuara dhe biznese nga diaspora që kanë gjetur vend për të investuar në atdheun e tyre.

Blerta e di se rruga e grave të reja në TI nuk është përherë e drejtë. “Ka pengesa që nuk janë thjesht teknike: mungesa e vetëbesimit, stereotipet gjinore dhe mungesa e modeleve dhe rrjeteve profesionale për zhvillim. Por, e tëra që nevojitet është një hap, një përpjekje, një dorë e zgjatur për të ndihmuar”, thotë ajo. “Ajo që do të doja t’u thosha vajzave është: Provojeni! Jini kureshtarë, jini këmbëngulëse, mësoni çdo ditë!”.

Në pesë apo dhjetë vitet e ardhshme, Blerta dëshiron të shohë më shumë gra në ballë të zhvillimeve teknologjike.

“Dua të shoh gra që janë themeluese të bizneseve dhe lidere të inovacionit. Për ta bërë këtë të mundur, edhe unë e kam një përgjegjësi: me hapësira, mentorim, shembull personal dhe komunitet”.



Valdete Marevci-Dërmaku

*Inxhinierë, Termokos Sh.A.
(Ngrohtorja e Qytetit,
Prishtinë)*

**Gruaja që "guxoi" të bëhej
inxhinierë mekanike.**

Kur Valdete Marevci-Dërmaku u regjistrua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës në vitin 1997, ajo ishte e vetmja vajzë në gjeneratën e saj që e studionte inxhinierinë mekanike. Para kësaj, ajo i kishte përfunduar dy vjet e gjysmë studime teknike në Ferizaj, të ndjekura nga një pushim dyvjeçar, para se ta vazhdonte shkollimin e saj në Prishtinë.

Duke u kthyer pas në kujtime, ajo thotë se: "studimet teknike ishin shumë sfiduese, por më motivuan krenaria dhe respekti i treguar nga profesorët dhe kolegët e mi". Kjo përvojë e hershme ia formësoi guximin dhe vendosmërinë që do ta karakterizonin gjatë tërë karrierës së saj.



Pas diplomimit, Valdetja nisi të punonte në KFOR, si Inxhinierë e Kontrollit të Cilësisë së Ndërtimit, e pastaj në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Kur aplikoi për një pozitë në Termokos, ngrohtoren së qytetit, ajo u punësua menjëherë, ndërsa pas dy javëve punë u emërua si Ushtruese e Detyrës së Drejtores së Departamentit për Mirëmbajtje Mekanike. "Udhëheqja e një departamenti me 45 të punësuar ishte sfidë e madhe, por e kam pasur mbështetjen e kolegëve të mi", thotë ajo.

Në Termokos, Valdetja kontribuoi në zhvillimin e rrjetit, mirëmbajtjen e kaldajave dhe instalimin e pajisjeve, në një kohë kur kompania operonte me mazut. Sot, ajo është përgjegjëse për bashkërendimin midis Termokosit dhe institucioneve të shumta dhe përcjell projekte madhore zhvillimore, siç janë kogjenerimi dhe energjia solare. "Falë projekteve dhe mbështetjes së Komisionit Evropian, Termokosi po bëhet më eficient dhe më miqësor ndaj mjedisit", deklaroi Valdetja.

Megjithatë, përtej projekteve teknike, historia e Valdetes është histori e guximit dhe përkushtimit.

"I inkurajoj të gjitha vajzat që të ndjekin karriera teknike. Gratë dhe vajzat janë menaxhere të përkushtuara dhe të përgjegjshme. Ato nuk duhet të kenë frikë nga sfidat dhe gjithmonë do t'ia dalin mbanë".



III – Intervista me gratë që po e bëjnë ndryshimin në sektorin e TIK–ut

Pas historive të grave që e hapën rrugën dhe i hodhën themelet në fushën e teknologjisë, ky kapitull e ofron një pasqyrë të përgjithshme të grave që aktualisht po e bëjnë ndryshimin në sektorin e TIK–ut. Këto intervista janë më shumë se biografi; ato janë dëshmi të një epoke të re, në të cilën gratë jo vetëm që marrin pjesë, por edhe udhëheqin me vizion, guxim dhe kompetencë. Nga kodimi të siguria digjitale, nga ndërmarrësia të transformimi shoqëror, këto gra janë forca që e formësojnë të ardhmen.



Abetare Gojani

*Drejtoresh Ekzekutive,
Foundation House*

"Zëri" që i hap dyert për vajzat në teknologji

Në një industri ku ende ndihet paragjykimi gjinor, Abetare Gojani ka zgjedhur t'i refuzojë kufizimet e caktuara nga të tjerët. "Fillesat nuk i pata të lehta", tregon ajo. "Hyra në një fushë, në të cilën mungesa e grave në pozita menaxheriale apo teknike ishte evidente. Por, përvoja me vajzat që nuk mund t'i bindnin madje as familjet e tyre që ta ndiqnin një rrugë në teknologji, më shtyu që të angazhohesha edhe më fort. Ky është bërë motivimi për misionin tim: që ta thyej mitin se teknologjia është fushë për burra". Ky mision nuk ka mbetur vetëm ide. Gjatë viteve të fundit, Abetare Gojani është përfshirë në shumë programe që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në vajzat dhe gratë e reja në Kosovë, duke u ofruar atyre qasje në trajnime, mentorim dhe mundësi që dikur janë dukur të paarritshme. "Një përvojë që nuk



do ta harroj kurrë ishte kur gjatë pandemisë arritëm t'i mbështesnim 190 vajza nga komuniteti rom, ashkali dhe ai egjiptian me laptopë dhe trajnim bazik", sjell ndërmend ajo. Shumë nga to sot ose po e vazhdojnë edukimin, ose janë regjistruar në programet tona të avancuara. Ishte një moment që ma dëshmoi se ndryshimi fillon me një kompjuter, por përfundon me një jetë më të mirë".

Në çdo hap të rrugës, Abetare Gojani ka ndjerë edhe skepticizëm, edhe frymëzim. "Unë, si shumë vajza të tjera, jam përballur me pyetje si:

“pse je në teknologji?” ose “a nuk është kjo një fushë për burra?”. Por, çfarë që më ka nxitur të vazhdoja tutje ka qenë dëshira për të dëshmuar se gratë jo vetëm që kanë vend në këtë fushë, por mund të jenë edhe lidere dhe modele frymëzuese”.

Ky vizion çoi në themelimin e Foundation House, ku Abetare Gojani shërben si Drejtore Ekzekutive, organizatë kjo që, që më shumë se një dekadë, u ka ndihmuar mbi 50,000 të rejave dhe të rinjve në Kosovë që të përvetësojnë shkathtësi në TIK, STEM dhe inovacion. Megjithatë, Abetare Gojani mbetet realiste.

“Statistikat ende tregojnë pabarazi gjinore të konsiderueshme në kompanitë e TIK–ut. Kjo do të thotë se rrugëtimi nuk ka mbaruar dhe se ende kemi shumë punë për të bërë. Por, jam e bindur se ndryshimi ndodh sa herë që një vajzë zgjedh të mos dorëzohet”.



Jeta Zagragja

Themeluese dhe Shefe Ekzekutive, AnchorzUp

Jeta, e cila ndërton ura digjitale nga Kosova për në botë

Pas përfundimit të studimeve në ShBA në vitin 2015, Jeta Zagragja vendosi të kthehej në Kosovë për ta ndërtuar një karrierë në një industri që e transformon çdo aspekt të jetës, në teknologji. Përvoja e saj e hershme në Gjirafa, një platformë kërkimi dhe tregtie elektronike në gjuhën shqipe, dhe në Cactus, njëra nga kompanitë e para të TI-së dhe zhvillimit të softuerëve në Kosovë, i vuri themelet për një karrierë që së shpejti do të zgjerohej me një temp të pabesueshëm. Dy vjet pas kthimit në Kosovë, në vitin 2017, ajo ishte ndër themelueset e UCX-it, një kompani që arriti të rritej e t'i kishte më shumë se 90 punonjës dhe që u shit me sukses në vitin 2021. Sot, si themeluese e AnchorzUp, Jeta e udhëheq një kompani që zhvillon zgjidhje



digjitale për klientë në Amerikë, Zvicër, Australi dhe Kanada, duke e pozicionuar Kosovën në hartën globale të inovacionit.

Rruga drejt suksesit nuk ka qenë e lehtë. Ajo është ngritur mbi përpjekje të vazhdueshme, përkushtim dhe guxim për të ecur përpara edhe në momente të pasigurisë. Sfidat siç janë sigurimi i investimeve, ndërtimi i ekipeve, krijimi i një kulture organizative që e vlerëson profesionalizmin dhe përfshirjen apo përballja me paragjykimet ndaj tregut të Kosovës e kanë forcuar vizionin e saj edhe

më shumë. “Çdo arritje ka qenë rezultat i punës konsistente, përkushtimit dhe guximit për të mësuar nga dështimet”, thekson ajo. Për Jetën, suksesi profesional dhe familja nuk janë zgjedhje që e përjashtojnë njëra-tjetrën. Ato mund të bashkëjetojnë kur ka mirëkuptim dhe fleksibilitet në vendin e punës.

“Kur një grua i ndihmon një tjetër, i tërë sistemi përfiton. Kjo është domethënia e vërtetë e fuqizimit”.



Donjeta Sahatçiu

*Drejtores / Kryesuese e
Kampusit, 42 Tirana*

Nga zyra komunale në një gjeneratë digjitale të re

Për Donjeta Sahatçiun, teknologjia nuk është thjesht kod apo ekran, por mënyrë për t'i afruar njerëzit me njëri-tjetrin. Ajo ka qenë përherë aty, në çdo hap të rrugëtimit të saj, nga një universitet i rrënjosur thellë në TI në menaxhim të kompanive digjitale, ku e ka kuptuar se çdo sistem i mirëfilltë fillon me komunikim dhe bashkëpunim.

Kur kaloi nga industria në komunë, Donjeta nisi ta shihte teknologjinë me një sy tjetër, si një mjet për qeverisje më inteligjente, më të afërt dhe më përfshirëse. Si Nënkryetare e Komunës së Prishtinës, nga shkurti i vitit 2022 e deri në vitin 2024, ajo e përdori funksionin e saj për të krijuar mundësi për gratë: trajnime digjitale, përfshirje në politikat lokale të punësimit dhe hapësira ku vajzat e reja mund të përpiqen, të mendojnë e të ndërtojnë.



*“Shpesh kam
qenë e vetmja
femër në
tavolinë, por
kurrë nuk kam
dashur të isha
e fundit, sepse
sa herë që një
vajzë e fiton
vendin që e*

meriton, hapet rruga për një tjetër pas saj”, shprehet ajo.

Nga punëtoritë e kodimit për më shumë se pesë mijë vajza e deri te digjitalizimi i proceseve që ua bëjnë jetën grave më të lehtë, për Donjetën, barazia nuk është kauzë, por mënyrë për të sjellë zhvillim me gjithë zemër.

Sot, në 42 Tirana, një shkollë kodimi pa pagesë që e përdor një model të të mësuarit nga njëri-tjetri dhe që është pjesë e Network 42, i cili ka shtrirje globale, ajo e sheh veten duke ia dhënë gjeneratës së re atë që dikur e ka kërkuar për vete: mundësinë për të besuar se, edhe këtu, mund të krijosh diçka që mund ta ndryshojë botën.



Zana Tabaku

Themeluese, APPDEC

Nga magjia e ekranit të parë te inteligjenca artificiale

Zana Tabaku ishte vetëm trembëdhjetëvjeçare kur pa kompjuter për herë të parë. "Ishte pas luftës në Kosovë, në një kohë kur teknologjia ishte edhe luks, edhe shpresë. Kur pashë ekranin duke reaguar ndaj komandave të mia, m'u duk si magji", sjell ajo kujtimet e saj. Për një vajzë që po rritej në një realitet të rindërtimit, ajo dritë e ftohtë e ekranit u bë simbol i një bote të re, një bote që e fliste gjuhën e mundësive.

Edhe pse më vonë zgjodhi ta studionte gjuhën dhe letërsinë angleze në Universitetin e Prishtinës, pasioni i saj për teknologjinë nuk e la të qetë. Ajo u regjistrua në një akademi të programimit në një kohë kur vajzat në këtë fushë ishin pothuajse të padukshme. "Isha vajza e vetme



në grupin tim, por e dija se përkisja aty", thotë ajo. Ajo përvojë, e krijuar midis vijave të kodimit dhe besimit, e çoi drejt një rruge që e përcaktoi karrierën e saj, nga kodimi i parë i saj e deri te inteligjenca artificiale.

Në moshën njëzetetrevjeçare, Zana e themeloi kompaninë Appdec, duke u bërë njëra nga gratë e para në Kosovë që krijoi kompani në fushën e TIK-ut. "Në atë kohë, ishte diçka e paprecedentë", sjell ndërmend ajo.

Me programin "Junior Geeks", të cilin e bashkëthemeloi për t'i frymëzuar të rinjtë në STEM, ajo u ka ndihmuar mbi 500 nxënësve të shkollave të mesme që të

fitonin shkathtësi praktike në teknologji, inovacion dhe të menduar kritik. Mbi 80% e tyre kanë ndjekur studime në fusha që ndërlidhen me TIK-un, ndërsa shumë nga ta tashmë janë të punësuar në kompani vendase dhe ndërkombëtare.

“Ndikimi më i madh i një kompanie nuk matet me produktet që i ofron, por me njerëzit që i edukon dhe frymëzon”, thotë ajo.

Sot, Zana të ardhmen e sheh në inteligjencën artificiale, një fushë të cilën ajo e përshkruan si “mënyra më e avancuar për ta kuptuar botën dhe për ta bërë atë më të drejtë”. Qëllimi i saj është që të zhvillojë inovacione që e ruajnë thelbin njerëzor të teknologjisë dhe ta ndërtojë një ekosistem ku gratë dhe vajzat janë pjesë e çdo niveli të transformimit digjital.



IV – Katalizatorët e ndryshimit

Në ndërtimin e një të ardhme më të barabartë dhe më përfshirëse, roli i organizatave që veprojnë si ura lidhëse midis potencialit të grave dhe mundësive reale është esencial. Në këtë kapitull është përshkruar baza institucionale dhe komunitare që e fuqizon suksesin individual të shumë grave që i kemi prezantuar deri më tani. Pa këta katalizatorë të ndryshimit, rrjete, programe, inkubatorë dhe nisma, talenti shpesh mbetet i pazhvilluar sa duhet, ndërsa ëndrrat e grave të reja mbeten pa mbështetje. Prandaj, Bashkimi Evropian, përmes mbështetjes së këtyre strukturave, investon në infrastrukturën sociale dhe profesionale që i bën të mundshme historitë e suksesit. Në këtë kapitull i kemi prezantuar disa organizata dhe rrjete që veprojnë si katalizatorë për ndryshim, duke i lidhur vajzat me mundësitë për edukim, mentorim dhe shtigje drejt karrierave në teknologji.

STIKK-u – zëri i sektorit të TIK-ut dhe lider i transformimit

Themeluar në vitin 2008, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK-u) është shndërruar në një nga organizatat kryesore që i përfaqësojnë kompanitë e TIK-ut në vend. Aktualisht, ajo përfaqëson më shumë se 100 anëtarë, ndërsa me aktivitetet e veta e mbulon më shumë se 60% të tregut të punës në TIK dhe mbi 75% të qarkullimit vjetor të këtij sektori. STIKK-u nuk është vetëm organizatë përfaqësuese. Ai gjithashtu e promovon transformimin, ndërsa kjo edhe falë mbështetjes së Bashkimit Evropian.

STIKK-u e ka themeluar TechPark Prishtina, një inkubator që shërben si vatër për 25 biznese fillestare, duke u ofruar mbështetje dyvjeçare dhe infrastrukturë moderne për rritje dhe zgjerim ndërkombëtar. Projekti STAR UP e ka luajtur një rol qenësor në funksionalizimin e këtij parku si hapësirë për inovacion dhe ndërmarrësi.

STIKK-u dhe partnerët e tij i organizojnë edhe edicionet e “Javës së Vajzave në TIK” në Kosovë, nisma këto që i angazhojnë vajzat në aktivitete teknike, seminare mentorimi dhe ekspozita. Në vitin 2025, seminare janë mbajtur në nëntë institucione në tetë komuna në mbarë Kosovën, me më shumë se 300 vajza pjesëmarrëse dhe 15 mentore profesionale nga organizata dhe kompani vendase dhe ndërkombëtare.

Gratë në STEM në Kosovë – komuniteti dhe rrjetëzimi për vajzat në STEM

Në Kosovë, gratë përbëjnë rreth 56% të të gjithë studentëve, rreth 32% në programet e STEM-it, ndërsa në sektorin e teknologjisë, ato përbëjnë më pak se 20% të fuqisë punëtore. Këto shifra tregojnë se pabarazitë gjinore në STEM mbeten të konsiderueshme.

Rrjeti “Gratë në STEM në Kosovë” është krijuar për t’i bërë bashkë vajzat dhe gratë që studiojnë ose punojnë në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, duke e ofruar një komunitet që ofron mentorim, punëtori dhe mundësi për rrjetëzim profesional. Sot, ky rrjet përfshin më shumë se 50 gra të suksesshme nga fusha të ndryshme të STEM-it dhe bashkëpunon ngushtë me universitetet publike në mbarë Kosovën.

Global Engineer Girls (GEG Kosova)

Global Engineer Girls (GEG Kosova) është një nismë edukative që mbështetet nga Limak Kosova dhe UNDP-ja dhe që i fuqizon vajzat që të ndjekin karriera në inxhinieri dhe STEM përmes bursave, mentorimit dhe praktikave. Përmes këtij programi, vajzat dhe gratë e reja kanë fituar qasje jo vetëm në mbështetje financiare, por edhe në përvojë praktike dhe udhëzime profesionale të vlefshme.

Qëllimi i kësaj nisme është që të sigurojë që suksesi i grave në STEM të mos mbetet vetëm arritje individuale, por të bëhet shteg që i frymëzon dhe inkurajon gratë e reja të tjera që të hyjnë dhe të lulëzojnë në këto fusha.

Vajzat në TIK – lëvizje që sjell ndryshim në terren

“Fuqizojmë, frymëzojmë, sjellim inovacion” është motoja që i udhëheq “Vajzat në TIK”, një lëvizje që e promovon pjesëmarrjen e vajzave në teknologji. Në Kosovë, kjo lëvizje bashkërendohet nga DigiWomen Cluster Kosovo, një rrjet i kompanive teknologjike të udhëhequra nga gratë që veprojnë nën patronazhin e STIKK-ut (luteni ta shihni artikullin për STIKK-un në faqen 11).

Gjatë “Javës së Vajzave në TIK”, gratë e reja përfshihen në punëtori, aktivitete praktike dhe rrjetëzim me mentore. Edicioni i vitit 2025 është

mbajtur në institucionet arsimore në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe në komunat përreth, ndërsa ka përfshirë institucione private dhe publike. Gjithsej, rreth 300 vajza kanë marrë pjesë në panele interaktive, pyetësorë dhe seanca të mentorimit me ekspertë nga fushat e teknologjisë dhe biznesit.





V – Forcat bashkëpunuese në qendër të vëmendjes

Në një ekosistem që ndryshon shpejt, fuqizimi i grave në teknologji nuk ndodh rastësisht. Ai arrihet përmes bashkëpunimeve, forumeve dhe ngjarjeve që ndërtojnë ura midis grave të reja, industrisë dhe institucioneve që besojnë në barazi dhe inovacion. Në Kosovë, disa nga këto nisma janë bërë shtylla të vërteta të zhvillimit.

Ky kapitull është esencial për këtë publikim, sepse tregon se fuqizimi gjinor në teknologji nuk është përpjekje e izoluar, por ngrihet mbi bashkëpunimin, ndarjen e njohurive dhe platformat që e mbështesin rrugëtimin nga ideja në zbatim. Këto forca bashkëpunuese e krijojnë një mjedis ku talenti i grave jo vetëm që njihet, por edhe lulëzon.

KosICT – kur industria dhe edukimi i bashkojnë forcat

KosICT, festivali më i madh i teknologjisë që organizohet nga STIKK-u, qëndron në zemër të ekosistemit të teknologjisë në Kosovë. Ky aktivitet i përvitshëm është më shumë se konferencë – është urë që i lidh botën akademike, industrinë dhe talentet e reja.

Përmes seancave të përputhjes B2B, ligjëruesve ndërkombëtarë dhe prezantimeve të bizneseve fillestare, KosICT e ofron një hapësirë ku vajzat dhe gratë e reja e kanë mundësinë që të takojnë mentorë, kompani dhe investitorë që mund ta ndryshojnë rrugëtimin profesional të tyre.

Në edicionet e fundit, vëmendje e veçantë u është kushtuar përfshirjes gjinore dhe pjesëmarrjes së vajzave në teknologji. Me mbështetjen e projekteve të financuara dhe mbështetura nga BE-ja, siç janë STAR UP dhe TechPark Prishtina, dhjetëra vajza kanë ndjekur trajnime, janë punësuar në kompani të TIK-ut ose i kanë themeluar bizneset fillestare të tyre. Ky lloj bashkëpunimi ia hap dyert e kësaj industrie një gjenerate të re të profesionistëve që po e transformojnë mënyrën se si teknologjia po perceptohet në Kosovë.




DOKU.TECH – frymëzim midis artit, teknologjisë dhe ndryshimit

Në një atmosferë në të cilën kultura gërshetohet me inovacionin, DOKU.TECH-u është bërë njëra nga ngjarjet më frymëzuese për të rinjtë, e posaçërisht për vajzat që kërkojnë ta gjejnë vendin e tyre në teknologji. Që nga themelimi i tij në vitin 2014, ky festival ka mbledhur më shumë se 15,000 pjesëmarrës dhe më shumë se 100 ligjërues ndërkombëtarë, duke e transformuar Prizrenin në qendër të dialogut midis artit, shkencës dhe shoqërisë digjitale.

Në secilin edicion, DOKU.TECH-u sjell tema që ndikojnë në të ardhmen: inteligjenca artificiale, etika digjitale, siguria kibernetike dhe ndikimi social i teknologjisë. Organizatorët e festivalit raportojnë se, viteve të fundit, pjesëmarrja e ligjërueseve femra ka arritur në rreth 40%, duke e bërë këtë ngjarje model të përfaqësimit gjinor në teknologji.

Në skenën e DOKU.TECH-ut, vajzat e reja gjejnë frymëzim përtej teknologjisë: ato mësojnë për bashkëpunimin, guximin dhe kreativitetin. Një nga panelet më të fundit, "Përsheptimi i përfaqësimit të grave në IA", e ka theksuar domosdonë që gratë të përfshihen në procesin e krijimit të zgjidhjeve digjitale dhe në vendimmarrje, sepse, siç u theksua, teknologjia e së ardhmes duhet ta pasqyrojë zërin dhe diversitetin e të gjithëve.



Java Globale e Ndërmarrësisë – hapësirë që e lidh inovacionin me veprimin

Java Globale e Ndërmarrësisë (JGN-ja) është nismë globale që frymëzon miliona të rinj në më shumë se 200 vende për ndërmarrësi, krijim dhe inovacion. Në Kosovë, GEW organizohet nga Qendra e Inovacionit në Kosovë (ICK-ja), një qendër lidere që i mbështet bizneset fillestare përmes inkubacionit, trajnimit dhe programeve në komunitet, në bashkëpunim me më shumë se 45 organizata partnere, duke u bërë njëra nga platformat më të rëndësishme për promovimin e ndërmarrësisë, inovacionit dhe zhvillimit të ekosistemit të bizneseve fillestare.

Secili edicion i JGN-së sjell aktivitete që e ndërlidhin kreativitetin me zgjidhje praktike: gara të dizajnit inovativ, punëtori ndërdisiplinore, prezantime të bizneseve dhe takime me investitorë vendas dhe ndërkombëtarë. Në edicionin e vitit 2025, që u mbajt në bashkëpunim me shkolla, universitete dhe qendra të inovacionit në mbarë Kosovën, u zhvilluan ngjarje në nëntë institucione në tetë komuna, në të cilat u angazhuan më shumë se 300 gra të reja dhe 15 mentore profesionale nga organizata dhe kompani vendore dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrëset punuan në projekte që e lidhin teknologjinë, ndërmarrësinë dhe ndikimin në komunitet – duke e vazhduar misionin për ta frymëzuar gjeneratën e ardhshme të grave inovatore.



VI – Edukatorët që e trasojnë rrugën për vajzat në teknologji

Nëse ka ndonjë faktor kyç që e përcakton suksesin afatgjatë të përfshirjes së grave në teknologji në Kosovë, ai është edukimi. Edukimi jo vetëm si sistem formal, por si përvojë që ndërtohet me shembuj, mentore dhe lidere që nuk e mbajnë dijen për vete, por e ndajnë atë për t'u ndihmuar të tjerave që të rriten. Ky kapitull sjell në pah figurat që po i hedhin këto themele – gratë që, përmes mësimdhënies, mentorimit dhe krijimit të institucioneve edukative të reja, po e trasojnë rrugën për gjeneratat e ardhshme.



Akademia jCoders – nga studente në mentore

E themeluar në vitin 2015, jCoders është njëra nga akademitë më të rëndësishme që synon t'i zhvillojë shkathtësitë digjitale tek fëmijët dhe të rinjtë. Me degë në Prishtinë, Mitrovicë të Jugut, Gjilan dhe Pejë, ajo ofron kurse për programim, elektronikë dhe robotikë për moshat 7–18 vjeç.

E mbështetur nga Bashkimi Evropian për disa projekte, përveç mësimdhënies teknike, jCoders e ka krijuar një cikël të ndikimit ku shumë vajza që kanë filluar si praktikante tani janë pjesë e staftit si mentore. Ky model jo vetëm që i fuqizon ato personalisht, por e krijon edhe një zinxhir edukativ, ku frymëzimi shndërrohet në ndikim konkret.

Foundation House – një dekadë e krijimit të mundësive për vajzat

Një tjetër shtyllë e edukimit është Foundation House, e cila ka qenë forca shtytëse pas programit madhor “Vajzat në TIK”. Në prill të vitit 2024, në kampusin e Institutit të Teknologjisë Rochester (RIT) në Kosovë, ky program e shënoi dhjetëvjetorin e tij me një konferencë ku u prezantuan të arriturat: më shumë se 3,000 vajza kanë kryer trajnime, mentorime dhe kanë marrë pjesë në aktivitete të tij. Në këtë hapësirë, vajzat takohen me profesioniste frymëzuese nga sektori privat, akademik dhe ai institucional – një rrjet që i lidh ato me mundësi reale dhe e rrit vetëbesimin e tyre për të hyrë në fushat e STEM-it.

Çfarë është me rëndësi, ky program arrin edhe tek vajzat nga komunitetet pakicë në mbarë Kosovën, duke siguruar që mundësitë në teknologji dhe edukim të jenë përfshirëse dhe të qasshme për të gjithë. Përmes nismave siç janë si “Katalizatori i Inovacionit për Pakicat”, që zbatohet nga Foundation House, dhjetëra vajza nga komuniteti rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, serb dhe ai goran, kanë fituar shkathtësi digjitale dhe financiare, kanë marrë pjesë në seanca të mentorimit dhe kanë hartuar projekte në komunitet në të cilat teknologjia përdoret për ndikim social. Këto nisma jo vetëm që krijojnë vetëbesim dhe mundësi për punësim, por gjithashtu krijojnë modele që i frymëzojnë gratë e reja të tjera që të ndjekin rrugë të ngjashme.





Shkolla Digjitale – lidershipi nga brendia e sistemit

Shkolla Digjitale, e themeluar dhe udhëhequr nga Hana Qerimi, është njëra nga nismat më të suksesshme në Kosovë, e cila e kombinon edukimin për teknologjinë me përfshirjen gjinore.

Me një staf të përbërë nga më shumë se 67% gra dhe një qasje që e promovon pjesëmarrjen aktive të vajzave, kjo shkollë e ka transformuar edukimin për teknologjinë në një mjedis përfshirës dhe frymëzues.

Gjatë “Javës së Vajzave në TIK 2024”, më shumë se 100 vajza kanë marrë pjesë në punëtori dhe aktivitete që janë zhvilluar nga kjo shkollë, duke ua shtuar atyre vetëbesimin dhe duke krijuar kompetenca të reja.



Një arritje ndërkombëtare e madhe u shënua me nënshkrimin e marrëveshjes me Berlitz-in, një lider global në edukimin dhe trajnimet gjuhësore, duke i hapur rrugë kështu zgjerimit të programit të Shkollës Digjitale në rreth 500 vende në nivel global dhe duke e shndërruar një nismë lokale në një histori suksesi me ndikim ndërkombëtar.

Ndërkohë, Hana është bërë njëra nga figurat më të fuqishme që po ndihmon për ta ndryshuar këtë fushë. Ajo e ka krijuar një model të edukimit që jo vetëm përçon njohuri për teknologjinë, por edhe frymëzon. "Që nga fillimi, më tërhoqi ideja se përmes teknologjisë mund të krijohet diçka që vërtet ndikon në njerëzit, një zgjidhje, një përvojë, një mundësi e re", thotë Hana, duke bërë të ditur se motivimi i saj ka qenë përherë i lidhur me ndikimin social të teknologjisë.

Shkolla Digjitale bazohet në filozofinë se teknologjia duhet të jetë e qasshme për të gjithë, posaçërisht për vajzat dhe gratë që tradicionalisht kanë qenë të përjashtuara nga kjo fushë.

“Të jesh model frymëzues për gratë e reja është përgjegjësi, por edhe privilegj. Ne i inkurajojmë vajzat që të kenë vetëbesim, të eksperimentojnë dhe të marrin vendime të guximshme, sepse teknologjia nuk është vetëm kodim; është kreativitet, është zgjidhje e problemeve dhe është mënyra për t’u bërë lidere të së ardhmes”, thekson ajo.

Për Hanën, suksesi i vërtetë nuk matet vetëm me të dhënat statistikore për pjesëmarrjen e vajzave në STEM, por edhe me transformimin që ndodh kur një vajzë e re e sheh veten si krijuese, e jo vetëm si përdoruese e thjeshtë e teknologjisë.





VII – Urat midis arsimit dhe mundësive

Në Kosovë, një ekonomi digjitale e qëndrueshme nuk mund të zhvillohet pa një lidhje të fortë midis arsimit dhe tregut të punës. Kjo lidhje po ndërtohet nëpërmjet institucioneve ndërmjetëse siç janë VentureUP, Cactus Education dhe BIT Academy, hapësira këto ku teoria takohet me praktikën dhe ku të rinjtë, e posaçërisht vajzat, përgatiten për botën reale të punës dhe inovacionit.

VentureUP – lidhja midis universitetit dhe tregut të punës

Një shembull i tillë është VentureUP, Qendra për Ndërmarrësi dhe inkubatori zyrtar i Universitetit të Prishtinës, i cili u ka ndihmuar më shumë se 50,000 të rinjve e të rejave që t'i kombinojnë njohuritë akademike me përvojat praktike dhe ndërmarrëse. Në bashkëpunim me ekspertë të industrisë dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian, VentureUP harton programe të trajnimit, përzgjedh trajnerë dhe ofron mundësi për praktikë ose punësim për pjesëmarrësit që i përfundojnë me sukses ato. Vetëm në vitin 2024, 160 të rinj, duke përfshirë 92 vajza, e kanë përfunduar njërin nga dhjetë programet e trajnimit që janë ofruar. Që nga themelimi, më shumë se 3,000 studentë kanë marrë pjesë në programe të ndryshme, ndërsa 45% e tyre janë punësuar në sektorin privat.



Cactus Education – edukimi digjital me qasje praktike

Me qasjen e tij të “edukimit bashkëpunues”, Cactus Education, një institucion aftësimi profesional, paraqet model inovativ të edukimit të integruar në fushën e teknologjisë. Studentët e ndjekin pjesën teorike në shkollë, ndërsa praktikën profesionale e mbajnë në kompani teknologjike, duke krijuar përvojë reale që i sjell më afër tregut të punës.

E licencuar nga Ministria e Arsimit dhe e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Cactus Education është shkolla e parë profesionale dyvjeçare në Kosovë që e ofron një model të të mësuarit praktik në bashkëpunim me industrinë.

Në kuadër të projekteve të mbështetura nga Bashkimi Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë, ky institucion ka hartuar programe që i fuqizojnë vajzat dhe gratë në teknologji përmes trajnimit, mentorimit dhe praktikave profesionale. Projektet si “Skill Factory” dhe “Cooperative Training (CT)” synojnë ta rrisin përfaqësimin e grave në sektorin e TI-së dhe t’u ndihmojnë të rinjve që të ndërtojnë karriera të qëndrueshme në tregjet digjitale vendase dhe ndërkombëtare.





BIT Academy – teknologjia me fokus të drejtpërdrejtë

E themeluar në vitin 2013, BIT Academy është ndër institucionet e para në Kosovë që ofron trajnime profesionale në teknologji, të ndërtuara sipas nevojave reale të tregut të punës. Përmes qasjes praktike “aftësohu, dallohu, punësohu”, kjo akademi u ndihmon të rinjve që të zhvillojnë shkathtësi teknike dhe profesionale që i përgatisin për karriera të qëndrueshme në TI.


BIT Academy specializon në trajnime si Cisco CCNA, QA, zhvillim të rrjetit dhe menaxhim të sistemeve, duke ofruar mentorim individual dhe mjedis bashkëpunues për zhvillim profesional. Në kuadër të projekteve të mbështetura nga programi Youth Online and Upward (YOU) – një nismë e zbatuar nga Ministria e Ekonomisë e Kosovës për t’i pajisur të rinjtë me shkathtësi digjitale dhe për t’i lidhur ata me mundësi të punësimit online – kjo akademi ka ofruar trajnime në gjuhën Python, duke ua ofruar të rinjve një mundësi që të fitojnë njohuri praktike dhe të kenë qasje në tregun digjital.

Me një rrjet të gjerë të ligjëruesve dhe profesionistëve të kësaj industrie, BIT Academy po ndihmon në rritjen e përfaqësimit të vajzave dhe grave në teknologji, duke e shndërruar interesimin e tyre për inovacion në karriera të prekshme dhe ndikim afatgjatë.

Qendra e Inovacionit Graçanica – mbështetja e vajzave në teknologji

Për disa vite, Qendra e Inovacionit Graçanica (GIC) ka punuar për t'i fuqizuar të rinjtë përmes teknologjisë, inovacionit dhe edukimit digjital. Fokus i veçantë i programeve të saj është përfshirja e grave dhe vajzave nga komuniteti serb i Kosovës, duke u ndihmuar atyre që të fitojnë vetëbesim dhe shkathtësi në fushën e teknologjisë.

Përmes trajnimeve për printim në 3D, dizajn digjital, programim në Arduino dhe njohuri digjitale, pjesëmarrëset kanë mësuar ta aplikojnë teknologjinë në mënyrë kreative, nga përdorimi i Canva-s dhe mjeteve të marketingut online e deri te punimi i produkteve artizanale përmes gdhendjes me laser dhe dizajnit në 3D.



Në tri vitet e fundit, mbi 60 gra dhe vajza u janë bashkëngjitur programeve të GIC-it, ndërsa disa nga to kanë vazhduar si mentore dhe asistente në punëtori të reja. Një pjesëmarrëse, pasi e ka përfunduar trajnimin për dizajn në 3D, tani i zhvillon produktet vendase të saj dhe trajnon vajza më të reja, duke dëshmuar se si mundësitë çojnë në fuqizim. Duke parë përpara, GIC-i planifikon ta lansojë programin “Vajzat në Inovacion”, një program i ri për ndërtim të shkathtësive teknike dhe të udhëheqjes në mesin e vajzave të shkollave të mesme në komunitetet me shumicë serbe në mbarë Kosovën.





VIII – Transformimi: nga nxënëse në sipërmarrëse

Fuqia e këtyre institucioneve nuk qëndron vetëm në statistika ose bashkëpunime, por edhe në historitë e vërteta të vajzave që kanë kaluar nëpër to. Qoftë përmes një trajnimi të parë që e ka ngjallur një pasion të fshehur, një mentoreje që e ka udhëzuar apo një mundësie për praktikë që ia ka rritur vetëbesimin, përvoja e çdo vajze është dëshmi e ndikimit që ndodh kur edukimi i dedikuar takohet me potencialin e gjeneratës së re. Historitë e disave nga to që janë prezantuar në tekstin e mëposhtëm tregojnë se si investimi në edukim teknologjik është investim në histori të sukseseve të reja. Ndërkaq, për ato që i udhëzojnë dhe u japin mësim, ndryshimi është po aq i dukshëm.



Për **Bardha Ajvazin**, bashkëthemeluese e Brandfluence, një agjenci e marketingut dhe komunikimit digjital me seli në Prishtinë dhe e specializuar për branding, ndikimi i edukimit është diçka që ajo e dëshmon çdo ditë. Ajo ka bashkëpunuar me Cactus Education, RIT Kosova, si dhe me organizata siç janë Women in Tech Kosovo dhe Digiwomen STIKK në zhvillimin e trajnimeve që i forcojnë jo vetëm shkathtësitë teknike, por edhe ato të udhëheqjes, komunikimit dhe të menduarit kreativ. Sipas Bardhës, “vajzat që regjistrohen në këto akademi jo vetëm që mësojnë të kodojnë, por edhe e fitojnë guximin për të ndërtuar diçka të veten”.

Ndërkohë, një trajnim i thjeshtë për dizajn në 3D në Qendrën e Inovacionit Graçanica (GIC) ia ka ndryshuar plotësisht rrugëtimin **Mateja Kosiqit**.

“Gjithmonë më ka pëlqyer ta kombinoja artin me teknologji”, shprehet ajo. “Por, ishte gjatë këtij kursi që kuptova se si idetë mund të bëhen diçka e prekshme, diçka që njerëzit mund ta mbajnë në dorë dhe ta përdorin në të vërtetë”.

Ajo përvojë e parë u bë shkëndija që e formësoi të ardhmen e saj. “Trajnimi nuk më dha vetëm njohuri teknike, por edhe vetëbesim”, thotë Mateja. “Më bëri të mendoja si krijuese, jo vetëm si nxënëse”.

Çka u nis si eksperiment i vogël, tani është shndërruar në nismë lokale: Mateja i dizajnon dhe prodhon krijimet e saj të printuara në 3D, duke i lidhur elementet tradicionale me dizajnin modern. “Doja ta sillja kulturën tonë në diçka të freskët dhe të dobishme. T’i shoh njerëzit duke përdorur diçka që e kam bërë unë, është shpërblimi më i madh”.

Sot, ajo e ndan këtë pasion me vajza më të reja që po e zbulojnë teknologjinë për herë të parë. Si mentore në punëtoritë e GIC-it, Mateja u ndihmon atyre që ta mposhtin frikën dhe dyshimin në vetvete. “Dua që ato ta kuptojnë se teknologjia nuk është fushë që u përket vetëm meshkujve. Është një hapësirë përplot me kreativitet, guxim dhe mundësi”, thotë ajo.

“Mos e pritni momentin e përkryer, nisjani tani! Çdo hap i vogël ka rëndësi, ndërsa guximi përherë shpie në rritje”.



Një trajnim i thjeshtë për menaxhim të rrjeteve sociale ia ndryshoi plotësisht itinerarin edhe **Diora Binxhiut**. "Isha njëzetvjeçare dhe, si shumë të rinj në atë kohë, e shihja teknologjinë si diçka që na ndihmon të lidhemi me njëri-tjetrin dhe t'i tregojmë njëri-tjetrit për jetën tonë të përditshme, por jo si mjet për ta ndërtuar të ardhmen", shprehet ajo. Ajo seancë e parë e trajnimit e bëri që të mendonte përsëri për gjithçka. Aty lindi ideja se rrjetet sociale nuk janë vetëm për të ndjekur, por edhe për të udhëhequr. "Kuptova se teknologjia të jep një zë, ndërsa, nëse e përdor me qëllim të qartë, të jep edhe ndikim".

Kjo ide u shndërrua në vizion: në moshën njëzetekatërvjeçare, Dora e themeloi Polar Bear Agency, agjencinë e parë të marketingut të gjelbër në Kosovë dhe në rajon. Me një qasje unike që i bashkon teknologjinë, kreativitetin dhe aktivizmin mjedisor, Dora e ndërtoi një hapësirë që nuk ekzistonte më parë. "Për mua, ishte një mënyrë që të bëja diçka në të cilën besoj". Që më shumë se një dekadë, Dora është bërë njëri nga zërat më të përkushtuar për përfshirjen e vajzave në sektorin digjital. Ajo ka mbajtur trajnime, ka mentoruar vajza të reja dhe, në panele ndërkombëtare, ka folur për rëndësinë e qasjes në hapësira që e ushqejnë guximin dhe vetëbesimin.

Poshtëshënim:

Në këtë publikim është shpalosur një mozaik i historive të vërteta, rrugëtimeve personale dhe nismave kolektive që e demonstrojnë fuqinë e grave për t'i transformuar jo vetëm jetët e tyre, por edhe të ardhmen e teknologjisë në Kosovë.

Nga klasat dhe laboratorët e deri te akademitë digjitale, bizneset fillestare, mentorimi dhe komunitetet e guximshme, gratë dhe vajzat që i keni takuar në këto faqe po e ndërtojnë një realitet të ri, më të barabartë dhe më përfshirës.

“Nga vizioni në inovacion: Rrugëtime frymëzuese të grave në teknologji” është më shumë se dokumentim i të arriturave; është thirrje për vazhdimësi, për besim në potencialin e çdo vajze dhe për përkushtim të përbashkët për ta bërë teknologjinë hapësirë të mundësive për të gjithë.

Autore: Aurela Kadriu, Naile Dema

Redaktimi dhe lektura: Europe House Kosova dhe Bashkimi Evropian në Kosovë

Dizajni grafik: Gentiana Shabani, Europe House Kosova

Përkthimi dhe shtypi: Europe House Kosova

2025© – Të drejtat autoriale për publikim: Bashkimi Evropian në Kosovë

** Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*





European Union
in Kosovo



EUROPE
HOUSE

Europe House në Prishtinë
Rr. UÇK, nr. 90
Prishtinë 10000, Kosovë
Telefoni: +383 (0) 38 25 99
E-mail: info@europehouse-kosovo.com

Bashkimi Evropian në Kosovë
Rr. Kosova 1,
Prishtinë 10000, Kosovë
Telefoni: +383 (0) 38 5131 200 99
E-mail: delegation-kosovo@eeas.europa.eu

Europe House në Mitrovicë të Veriut
Rr. Kralj Petar I p.n.,
Mitrovicë e Veriut 40000, Kosovë
Telefoni: +383 47 125 275
+381 64 9725 856
E-mail: info@europehouse-kosovo.com